



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1339 prot.

Himarë, më 19.02 . 2026

VENDIM

Nr. 01 , Datë 16.02 .2026

PËR

“MIRATIMIN E TRANSFERIMIT TË PASURISË TË LLOJIT KULLOTË, ME NR. PASURIE 68/119/15, E NDODHUR NË ZONËN KADASTRALE 1739, ME SIPËRFAQE TOTALE 2555 m², NGA PRONËSI E BASHKISË HIMARË TEK MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT”

Bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i përitësuar), neni 9, pika 1.2; neni 27, pika 5 dhe nenit 54; VKM-në nr. 433, datë 08.06.2016, “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish- komunave/bashkive” (i ndryshuar) pika 49 ; ligjit nr.9693/2007, “Për fondin kullosor”; VKM-në nr. 592, datë 09.10.2018 “Për disa ndryshime në VKM nr.1354, datë 10.10.2008 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave, që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor”; në vijim të shkresës nr.2572/1prot., të Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Himarë, pranë Këshillit Bashkiak Himarë: Këshilli Bashkiak Himarë në mbledhjen e datës 16.02.2026, miratoi me 15 (pesëmbëdhjetë) vota pro, 2 (dy) kundër, 0 (zero) abstenim dhe si më poshtë:

VENDOSI:

1. Miratimin për transferimin e pasurisë të llojit kullotë, me nr. pasurie 68/119/15, e ndodhur në zonën kadastrale 1739, me sipërfaqe totale 2555 m², nga pronësi e Bashkisë Himarë tek Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet administrata dhe Kryetari i Bashkisë Himarë.
3. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike, bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 55 pika 6.

KRYETARI
Dhimitër Kapaj

